



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS  
SENATI

Nr 80 Prot

Tiranë, më 17.01. 2019

**VENDIM**

**Nr. 1, datë 17.01.2019**

**“PËR**

**KRITERET E PRANIMEVE NË PROGRAMET E STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË DHE PËR PROGRAMET E INTEGRUARA TË STUDIMIT TË CIKLIT TË DYTË PËR VITIN AKADEMIK 2019-2020, NË UNIVERSITETIN POLITEKNIK TË TIRANËS”**

Mbështetur në Ligjin Nr.80/2015, datë 22.07.2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, Statutin e Universitetit Politeknik të Tiranës, Senati në mbledhjen e datës 17.01.2019,

**VENDOSI:**

- 1. Miratimin e kriterëve të pranimeve në programet e studimit të ciklit të parë dhe për programet e Integruara të studimit të ciklit të dytë për vitin akademik 2019-2020, në Universitetin Politeknik të Tiranës si më poshtë vijon:**

**A.** Kriteret e pranimit për programet e studimit të Ciklit të Parë, të ofruara nga Fakultetet e UPT si më poshtë:

**1. Fakulteti I Inxhinierisë Mekanike** me programet e studimit:

- Bachelor në Inxhinieri Mekanike
- Bachelor në Inxhinieri Materiale
- Bachelor në Inxhinieri Tekstili dhe Modë
- Bachelor në Inxhinieri Ekonomike

**2. Fakulteti i Inxhinierisë Elektrike** me programet e studimit:

- Bachelor në Inxhinieri Elektrike-Profil i Automatizim i Industrisë

UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANES

Adresa: Sheshi “Nene Tereza”, Nr.4, Tirane,  
Tel/Fax: +355 4 2227914,  
web: www.upt.al



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS  
SENATI

- Bachelor në Inxhinieri Elektrike-Profilë Energjitikë
- Bachelor në Inxhinieri Mekatronike

**3. Fakulteti i Gjeologjisë dhe Minerave** me programet e studimit:

- Bachelor në Inxhinieri Gjeoinformatikë
- Bachelor në Inxhinieri e Burimeve minerare
- Bachelor në Inxhinieri e Naftës dhe Gazit
- Bachelor në Inxhinieri Gjeomjedisi
- Bachelor në Inxhinieri Gjeologjike

**4. Fakulteti i Teknologjisë së Informacionit** me programet e studimit:

- Bachelor në Inxhinieri Elektronike
- Bachelor në Inxhinieri Telekomunikacioni
- Bachelor në Inxhinieri Informatike

**5. Fakulteti i Inxhinierisë së Ndërtimit** me programet e studimit:

- Bachelor në Inxhinieri Ndërtimi
- Bachelor në Inxhinieri Hidroteknikë
- Bachelor në Inxhinieri Mjedisi
- Bachelor në Inxhinieri Gjeodet

**6. Fakulteti i Inxhinierisë Matematike dhe Inxhinierisë Fizike**, me programet e studimit:

- Bachelor në Inxhinieri Matematike
- Bachelor në Inxhinieri Fizike

janë si më poshtë vijon:

- Kandidatët duhet të kenë mesataren e shkollës së mesme mbi 6 (gjashtë).
- Renditja e aplikantëve do të bëhet referuar pikëve të grumbulluara sipas formulës:

$$[0.7 * \text{Mes}_{(VKM)} + 0.3(0.5 * \text{Mes}_{(\text{Matematike})} + 0.4 * \text{Mes}_{(\text{Fizike})} + 0.1 * \text{Mes}_{(\text{Kimi})}] * K_{\text{koef. Shkollës}} * 1000$$

Ku:

- **Mes<sub>(VKM)</sub>**, nota mesatare e thjeshtë, e të gjitha viteve të shkollës së mesme, e përcaktuar me vendim të Këshillit të Ministrave për vitin akademik 2019-2020, sipas Ligjit Nr. 80/2015, datë 22.07.2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë, në Republikën e Shqipërisë" neni 74, pika 1;
- **Mes<sub>(Matematike)</sub>**, nota mesatare e thjeshtë e matematikës në të gjitha vitet e shkollës së mesme, përfshirë rezultatin në provimet e Maturës Shtetërore;

UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANES

Adresa: Sheshi "Nene Tereza", Nr.4, Tirane,  
Tel/Fax: +355 4 2227914,  
web: www.upt.al



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS  
SENATI

- **Mes<sub>(Fizike)</sub>**, nota mesatare e thjeshtë e fizikës, në të gjitha vitet e shkollës së mesme, përfshire rezultatin në Maturën Shtetërore të provimit me zgjedhje;
- **Mes<sub>(Kimi)</sub>**, nota mesatare e thjeshtë e kimisë në të gjitha vitet e shkollës së mesme përfshire rezultatin në Maturën Shtetërore të provimit me zgjedhje;
- **K<sub>koef. Shkollës</sub>**, koefiçenti i shkollës së mesme, për vitin akademik 2019-2020.

**B. Fakulteti i Arkitekturës dhe Urbanistikës**, për programet e integruara të studimit:

- Master i Shkencave në Arkitekturë-Profil i Arkitekt
- Master i Shkencave në Arkitekturë-Profil i Urbanist

Dhe për programin e studimit:

- Bachelor në Arkitekturë Interieri dhe Dizajn

ka vendosur këto kritere:

- Kandidatët duhet të kenë mesataren e shkollës së mesme mbi 6 (gjashtë).
- Renditja e aplikantëve do të bëhet referuar pikëve të grumbulluara sipas formulës:

$$0.6 * Mes_{(VKM)} * K_{koef. Shkollës} * 1000 + 0.4 * T_{(Testi)} * 100$$

**Mes<sub>(VKM)</sub>**, nota mesatare e përcaktuar me vendim të Këshillit të Ministrave për vitin akademik 2019-2020, sipas Ligjit Nr. 80/2015, datë 22.07.2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë, në Republikën e Shqipërisë" neni 74, pika 1;

**K<sub>koef. Shkollës</sub>**, koefiçenti i shkollës së mesme, për vitin akademik 2019-2020.

**T<sub>(Testi)</sub>**, rezultati i testimit, i organizuar nga Fakulteti i Arkitekturës dhe Urbanistikës, i cili përbëhet nga katër (4) komponentë:

- |  |                                      |
|--|--------------------------------------|
| • Test i arsyetimit logjik                       | 25% T <sub>(Testi)</sub> , (25 pikë) |
| • Test i kulturës së përgjithshme                | 25% T <sub>(Testi)</sub> , (25 pikë) |
| • Test i historisë dhe historisë së arkitekturës | 25% T <sub>(Testi)</sub> , (25 pikë) |
| • Test i vizatimit dhe prezantimit               | 25% T <sub>(Testi)</sub> , (25 pikë) |



KRYETARI

Prof. Dr. Andrea MALIQARI

UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANES

Adresa: Sheshi "Nene Tereza", Nr.4, Tirane,  
Tel/Fax: +355 4 2227914,  
web: www.upt.al